

VENDIM
Nr. 45, datë 16.6.2014

PËR AUTORIZIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik, me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., vendimit nr. 118, datë 18.10.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për emërimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a.”, si dhe nenit 11, pika 1, e rregullores, “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës.....2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dërguar me shkresën nr. 3704, datë 13.6.2014 “Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “CEZ a.s”,

VENDOSI:

1. Autorizohet z. Arben Seferi, administrator i përkohshëm i shoqërisë “Cez Shpërndarje” sh.a., që të marrë pjesë në procesin e finalizimit të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s.
 2. Në rast të arritjes së një marrëveshje, autorizohet z. Seferi, që të nënshkruajë marrëveshjen dhe çdo instrument që i bashkëlidhet asaj, në emër të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti